

www.zabgj.gov.al

Raport Vjetor

2011

Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor

Përmbajtja

Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjqësor, Prezantimi dhe Aktiviteti.....	3
I. Vështrim i Përgjithshëm.....	3
II. Misioni, Qëllimi, Roli, Funkzioni.....	4
II.1. Misioni i Z.A.B.GJ-së.....	4
II.2. Qëllimi i ZABGJ-së	4
II.2.1. Qëllimet strategjike.....	4
II.3. Roli i ZABGJ-së.....	4
II.4. Funkcionet kryesore të ZABGJ-së:.....	5
II.5. Politikat, Prioritetet:	6
III. Menaxhimi dhe organizimi	7
III.1. Bordi Drejtues i ZABGJ-së.....	7
III.1.1. Kompetencat kryesore të Bordit Drejtues	7
III.1.2. Aktiviteti gjatë vitit 2011.....	7
III.2. Struktura organizative e ZABGJ-së	8
IV. Aktiviteti i Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjqësor.....	9
IV. 1. Aktiviteti buxhetor gjatë vitit 2011	9
IV.1.1 Buxheti i miratuar për Pushtetin Gjqësor për vitin 2011.....	9
IV.1.2 Monitorimi dhe zbatimi i buxhetit për vitin 2011	12
IV.1.2-A Mekanizmat e monitorimit	12
IV.1.2.-B Rialokimi i fondeve	13
IV.1.3. Ecuria e realizimit të fondeve buxhetore për vitin 2011	16
IV. 2 Standardizimi i Shpenzimeve	26
IV.3 Aktiviteti Juridik.....	29
IV. 4. Auditimi.....	30
V. Bashkëpunimi me Institucionet e tjera	43
VI. Sfidat dhe objektivat për vitin 2012	43

Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, Prezantimi dhe Aktiviteti

I. Vështrim i Përgjithshëm

Në kuadër të garantimit të pavarësisë së veprimtarisë së organeve gjyqësore, Kushtetuta në nenin 144 ka parashikuar edhe pavarësinë financiare të gjykatave dhe të drejtën e tyre për të propozuar dhe administruar vetë buxhetin. Për këtë arsye, me Ligjin nr.8363, datë 01.07.1998, është krijuar Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, si një institucion i pavarur, që administron fondet buxhetore, të akorduara për pushtetin gjyqësor, duke siguruar në parim pavarësinë e tij ndaj pushteteve të tjera.

Përveç administrimit të fondeve buxhetore, për gjykatat, ligji i Zyrës, në nenin 4, pika a, i jep kësaj të fundit të drejtën për menaxhimin e investimeve të huaja në gjyqësor. Kontributi i saj konsiston si në rastin kur Zyra është vetë partnere në projekte dhe monitoron mbarëvajtjen e tyre, ashtu edhe përsa i përket projekteve në të cilat palë është Ministria e Drejtësisë. Në këto raste, Zyra ka rol koordinues, për të vënë në dispozicion të Ministrisë së Drejtësisë informacion të saktë mbi nevojat, si dhe të garantojë mbështetjen e investimeve pas përfundimit të projekteve.

Aktiviteti i Zyrës mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; Ligjin nr.8363, datë 01.07.1998 “Për krijimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor”; Ligjin Nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin për shërbimin civil dhe dispozitat ligjore në zbatim të tij; Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”; VKM nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”. Ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”; VKM nr.511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” i ndryshuar. Ligjet dhe VKM për punonjësit me kontratë të përkohshme pune; Ligjet dhe VKM për pagat dhe fondin e veçantë në institucionet buxhetore; Ligji nr.9936, dt.26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe dispozitat ligjore në zbatim të tij; Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me ligjin nr.9800, datë 10.09.2007, ligjin nr.9855, datë 26.12.2007, ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009, dhe ligjin nr.10309 datë 22.07.2010 dhe dispozitat ligjore në zbatim të tij; Ligjin nr.9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” si dhe në Manualin e Auditimit etj.

II. Misioni, Qëllimi, Roli, Funkcioni

II.1. Misioni i Z.A.B.GJ-së

Misioni themelor i Z.A.B.GJ-së është menaxhimi efektiv i fondeve buxhetore të akorduara për Pushtetin Gjyqësor, në funksion të zhvillimit të proceseve gjyqësore të drejta, të shpejta dhe transparente; dhënies së drejtësisë në kushte me akses të plotë për qytetarët dhe gjyqtarët duke synuar arritjen e standardeve bashkohore europiane, në kryerjen e proceseve gjyqësore.

II.2. Qëllimi i ZABGJ-së

Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor ka si qëllim plotësimin e nevojave të gjykatave me mjete financiare nëpërmjet: planifikimit dhe detajimit të fondeve buxhetore për çdo gjykatë, hartimit të procedurave për një administrim efektiv të fondeve buxhetore të akorduara për Pushtetin Gjyqësor, përdorimin e fondeve sipas legjislacionit në fuqi dhe kontrollin e vazhdueshëm të përdorimit me efektivitet të tyre.

II.2.1. Qëllimet strategjike

- Garantimi i burimeve të mjaftueshme financiare dhe përdorimi me efektivitet të tyre në funksion të përmbushjes së nevojave të gjykatave gjatë ushtrimit të aktivitetit të përditshëm në to.
- Arritja e standardeve bashkëkohore në drejtim të kushteve cilësore të punës dhe gjykimit për gjyqtarët dhe punonjësit e administratës gjyqësore; si dhe rritjen e cilësisë së shërbimit për qytetarët.
- Përmirësimi i procesit të hartimit të buxhetit dhe monitorimit të zbatimit të tij nga gjykata.
- Rritja e efektivitetit në shkëmbimin e informacionit, rritja e transparencës dhe standardizimi i shpenzimeve në funksion të procesit të gjykimit.
- Zgjerimi i veprimtarisë së Zyrës, në drejtim të menaxhimit të shërbimeve të gjyqësorit.

II.3. Roli i ZABGJ-së

Në kryerjen e rolit të saj, ZABGJ ka në vemendje të punës së saj:

- Studimin dhe përcaktimin e nevojave për buxhet të të gjitha gjykatave.
- Përpunimin e treguesve financiarë që kanë lidhje me kërkesat dhe veprimtarinë e gjykatave.
- Bashkëpunimin me sektorët financiarë të gjykatave .
- Kontrollimin e përdorimit të fondeve që u janë dhënë gjykatave sipas destinacioneve.

Vizioni ynë është t'i shërbejmë

“...një pushteti gjyqësor në Shqipëri që respekton të drejtat kushtetuese, mundëson administrimin në kohë dhe të paanshëm të drejtësisë, shfrytëzon politika efektive të menaxhimit dhe praktikat më të mira, lehtëson shfrytëzimin efektiv të fondeve dhe burimeve, përmirëson cilësinë e vendimmarrjes përmes aksesit në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë, siguron transparencë në vendimmarrje dhe veprime, rrit sigurinë dhe mbrojtjen si dhe siguron përgjegjësi publike.”

Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor ofron shërbim profesional, efikas dhe efektiv në gjykata duke u fokusuar në parimet bazë:

- Të jetë e paanshme dhe të punojë me integritet.
- Të mbrojë parimet e pavarësisë së gjyqësorit dhe llogaridhënies.
- Të jetë e arritshme, e përshtatshme dhe e kuptueshme.
- Të jetë efektive.
- Të jetë e përgjegjshme dhe të parashikojë nevojat e gjykatave të cilave u shërben.

II.4. Funkcionet kryesore të ZABGJ-së:

- Harton programin buxhetor afatmesëm dhe ndjek zbatimin e buxhetit vjetor të gjykatave, sipas rregullave dhe procedurave ligjore në Republikën e Shqipërisë;
- Menaxhon kontrollin e brendshëm financiar në gjykata;
- Monitoron dhe vlerëson përdorimin e fondeve në gjykata në përputhje me objektivat e përcaktuara;
- Menaxhon aktivitetin ekonomik - financiar të Zyrës;
- Deklaron rregullat e veta organizative dhe operative si dhe rregulloren e Zyrës;
- Mbështet zhvillimin e teknologjisë së informacionit në gjykata;
- Realizon raporte që lidhen me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore gjyqësore mbi përdorimin e fondeve buxhetore;
- Kontrollon përdorimin e fondeve buxhetore nga gjykatat në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;
- Përpunon e treguesit financiarë në lidhje me kërkesat dhe veprimtarinë e gjykatave;

- Njeh gjendjen fizike të gjykatave dhe studimin për zhvillimin e infrastrukturës së gjyqësorit si dhe përcakton nevoja të mëtejshme në investime;
- Asiston gjykatat në lidhje me njohjen më të mirë dhe zbatimin e akteve të reja ligjore e nënligjore, në fushën e zbatimit të buxhetit.

II.5. Politikat, Prioritetet:

Politika buxhetore e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor është orientuar drejt ndërmarrjes së hapave për përmirësimin e sistemit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit të pushtetit gjyqësor, si edhe përmirësimin të infrastrukturës gjyqësore në funksion të zhvillimit të proceseve gjyqësore dhe rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj publikut, me qëllim arritjen e standardeve bashkëkohore.

Politikat dhe prioritetet e ZABGJ-së konsistojnë si më poshtë:

- Përmirësimi tërësor i infrastrukturës ndërtimore të gjykatave, duke garantuar skemë funksionale efçente dhe bashkëkohore; mobilim të zyrave dhe sallave të gjyqit në përputhje me solemnitetin e gjykimit dhe plotësim të elementeve të sigurisë.
- Mbështetja në vazhdimësi me fonde buxhetore për rritjen profesionale dhe trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve.
- Ndjekja e politikave buxhetore fleksibile, gjatë zbatimit të buxhetit në funksion të objektivave dhe prioriteteve të përcaktuara, në varësi të situatave konkrete të krijuara.
- Vendosja e standarteve sipas grupeve të shpenzimeve që realizohen në funksion të procesit gjyqësor (shpenzime operative dhe investime).
- Përmirësimi në vazhdimësi i teknologjisë së informacionit në shërbim të procesit gjyqësor, me qëllim mbështetjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, rritjen e shpejtësisë në shkëmbimin e informacionit, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e shërbimit ndaj publikut.
- Përmirësimi i kuadrit ligjor të Zyrës nëpërmjet kontributit në Grupin e Punës, të ngritur nga Ministria e Drejtësisë, për rishikimin e ligjit aktual; si dhe hartimit të Rregullores së Brendshme të saj. Përmirësimi i kuadrit ligjor do të ndikojë, përveç të tjerash, edhe në përmirësimin e statusit të institucionit.
- Rritja dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe menaxhuese të Zyrës. Rishikimi i strukturës dhe organikës së saj.

III. Menaxhimi dhe organizimi

III.1. Bordi Drejtues i ZABGJ-së

Zyra drejtohet nga Bordi Drejtues i përbërë nga: Kryetari i Gjykatës së Lartë; një anëtar i Gjykatës së Lartë, i zgjedhur nga mbledhja e gjyqtarëve të kësaj gjykate; dy kryetarë të Gjykatave të Apelit, të zgjedhur nga mbledhja e përbashkët e kryetarëve të Gjykatave të Apelit; katër kryetarë të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore, të zgjedhur nga mbledhja e përbashkët e kryetarëve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë. Bordi drejtohet nga Kryetari i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.

III.1.1. Kompetencat kryesore të Bordit Drejtues

Bordi Drejtues i Z.A.B.GJ. është përgjegjës për:

- Miratimin e projekt-buxhetit të paraqitur nga administrata e Z.A.B.GJ-së, për gjykatat në të gjithë vendin;
- Kontrollin dhe menaxhimin e fondeve buxhetore, të akorduara për pushtetin gjyqësor;
- Emërimin apo shkarkimin e Drejtorit të Zyrës;
- Përcaktimin e strukturës së Zyrës, numrin e personelit administrativ si dhe kriteret e emërimit të tyre;
- Përcaktimin e nivelit të pagave të personelit të Zyrës në përputhje me kriteret e përgjithshme të caktimit të pagave për punonjësit e administratës shtetërore;
- Miratimin e rregullores së funksionimit të Zyrës;

III.1.2. Aktiviteti gjatë vitit 2011

Gjatë vitit 2011, janë zhvilluar 11 mbledhje të Bordit Drejtues, ku janë marrë vendime të rëndësishme lidhur me:

- Përcaktimin e politikave buxhetore, qëllimit, objektivave dhe kërkesave buxhetore të të gjithë gjykatave, pjesë e programit buxhetor afatmesëm 2012-2014.
- Organizimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, në përputhje me Ligjin nr. 9720 datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar me Ligjin nr.10318, datë 16.09.2010 si dhe Manualin e Auditimit.
- Rialokimet e fondeve buxhetore në shpenzime operative dhe investime.

- Përdorimin me efikasitet të fondeve buxhetore për sigurimin e objekteve të gjykatave, në zbatim të V.K.M. nr.333, datë 28.04.2010 “Për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve shtetërore”. Këtij qëllimi i shërben dhe Urdhëri i Përbashkët i Bordit Drejtues të ZABGJ-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme, për administrimin e objekteve të përbashkët, që do të sigurohen nga secila palë.
- Miratimin e Udhëzimit “Mbi unifikimin e praktikave për punën jashtë kohës normale të punës”.
- Hartimin nga ZABGJ dhe miratimin nga Bordi Drejtues i ZABGJ-së të Udhëzimit “Mbi Modelimin e godinave të gjykatave”, ku reflektohen standardet që duhet të aplikohen gjatë investimeve të ndërmara në lidhje me infrastrukturën ndërtimore të gjykatave.

III.2. Struktura organizative e ZABGJ-së

Struktura, organika dhe organizimi i brendshëm i Zyrës rregullohet me Vendime të Bordit Drejtues, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Institucioni ynë përbëhet nga 17 punonjës dhe, sipas Rregullores së Brendshme në fuqi, është i organizuar në katër sektorë: Sektori i Planifikimit dhe i Zbatimit të Buxhetit, Sektori i Auditimit, Sektori i Menaxhimit të Investimeve dhe Sektori i Administratës. Sektori i Buxhetit dhe i Auditimit drejtohen nga shefa sektori. Për sektorët që nuk kanë shefa sektori, komunikimi, marrja e detyrave dhe raportimi i tyre, kryhet drejtpërdrejt me Drejtorin e Zyrës. Të vepruarit në këtë mënyrë (për shkaqe objektive) shmang aktivitetet e kontrollit, sipas niveleve të menaxhimit. Në këtë aspekt nevojitet edhe rishikimi i strukturës organizative të Zyrës.

Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të marrëdhënieve të brendshme të Institucionit janë parashikuar në Rregulloren e brendshme të Institucionit, e cila është në proces rishikimi. Krahas rregullores janë përgatitur edhe kujtesa, urdhëra më të detajuara, më të plota në lidhje me funksionimin e brendshëm, të komunikimit ndërsektorial dhe nga lart poshtë e anasjelltas, rregullat e hyrjes në institucion, menaxhimin e kohës së punës dhe të pushimit, rregullat për mirëmbajtjen dhe sigurinë në ambientet e institucionit, të disiplinës, të etikës, të mbajtjes dhe menaxhimit të bazës materiale, pajisjeve elektronike dhe të postës elektronike.

Gjatë vitit 2011, nuk ka patur ndryshime si në numrin e punonjësve ashtu edhe në strukturën e Zyrës. Në zbatim të Ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” si dhe Manualit të Auditimit, është kryer ndryshimi i emërimit të Sektorit të Kontrollit në Njësi Auditimi të Brendshëm (NJAB). Është punuar në drejtim të hartimit të Draft-Rregullores së Brendshme të Zyrës si dhe është në proces rishikimi i strukturës aktuale organike, të cilat mendohet të finalizohen me përmirësimet që do të pësojë ligji aktual i Zyrës, gjatë vitit 2012.

IV. Aktiviteti i Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor

IV. 1. Aktiviteti buxhetor gjatë vitit 2011

Aktiviteti kryesor i sektorit të buxhetit konsiston në zbatimin e politikave buxhetore të Pushtetit Gjyqësor, përmes përgatitjes së buxhetit afatmesëm dhe vjetor; shpërndarjes së buxhetit për çdo gjykatë dhe menaxhimit të procesit të zbatimit të tij; monitorimit të shpenzimeve sipas programeve buxhetore duke analizuar performancën e treguesve buxhetor në arritjen e produkteve dhe përmbushjen e aktiviteteve të parashikuara.

Ky aktivitet, për vitin 2011, ka synuar në realizimin e objektivave të përcaktuara në Deklaratën e Politikës së Programit, pjesë e programit buxhetor afatmesëm, të cilat janë:

- Ofrimi i kushteve cilësore të punës, gjykimit dhe shërbimit për gjyqtarët dhe qytetarët, me qëllim arritjen e standardeve bashkëkohore, nëpërmjet: përmirësimit të skemës funksionale të godinave të gjykatave, deri në 60% të tyre; mobilimit të zyrave dhe sallave të gjyqit, deri në 64% të gjykatave dhe plotësimit me elemente të sigurisë, deri në 70% të tyre.
- Përmirësimi në vazhdimësi i infrastrukturës elektronike të gjykatave për mbështetjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, duke synuar plotësimin e 90% të gjykatave me 100% të pajisjeve.
- Forcimi i statusit të gjyqëtarëve, nëpërmjet rritjes profesionale dhe trajnimit të vazhdueshëm të tyre, duke mbështetur financiarisht realizimin e trajnimeve në vazhdimësi gjatë vitit.

IV.1.1 Buxheti i miratuar për Pushtetin Gjyqësor për vitin 2011

Me Ligjin nr.10355, datë 02.12.2010 “Për buxhetin për vitin 2011”, është miratuar buxheti për pushtetin gjyqësor, për vitin 2011, në vlerë 1,826,000 mijë lekë, përkatësisht 1,661,000 mijë lekë për shpenzime korente dhe 165,000 mijë lekë për investime.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm pasqyrohet buxheti për vitin 2011, sipas artikujve kryesorë të shpenzimeve, krahasuar me kërkesat në projekt-buxhet dhe buxhetin efektiv për vitin 2010.

Tabela nr.1

Buxheti i miratuar për Pushtetin Gjyqësor për vitin 2011¹

në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar për vitin 2010	Kërkesa në projekt-buxhet për vitin 2011	Buxheti i miratuar për vitin 2011	Raporti (%) buxheti i miratuar për vitin 2011/ vitit 2010	Raporti (%) buxheti i miratuar për vitin 2011/ kërkesës vitit 2011
1	Shpenzime personeli	1,257,000	1,365,544	1,361,000	+8%	-1%
2	Mallra dhe shërbime	222,700	396,960	299,820	+35%	-25%
3	Transferta për buxhetet Familjare dhe individët	180	180	180		
4	Investime	180,000	271,764	165,000	-8%	-40%
	TOTALI	1,659,800	2,034,448	1,826,000	+10%	-10%



¹ Buxheti i miratuar me ligj. Ky buxhet ka pësuar ndryshime gjatë vitit.

Buxheti i miratuar për Pushtetin Gjyqësor, për vitin 2011, ka në total një rritje 10% kundrejt vitit 2010. Në një analizë të mëtejshme sipas artikujve kryesorë, ndryshimet në buxhet kundrejt vitit 2011, paraqiten si më poshtë:

-Përsa i përket shpenzimeve të personelit (paga dhe sigurime shoqërore), vihet re një rritje rreth 8% kundrejt vitit 2011. Rritja e buxhetit për vitin 2011, vjen për shkak të rritjes me 26 punonjës, të numrit organik të miratuar me ligj për Pushtetin Gjyqësor, për vitin 2011, në funksion të planit afatmesëm për arritjen e numrit optimal të punonjësve të Pushtetit Gjyqësor, parashikuar për t'u realizuar, nëpërmjet një rritjeje të moderuar, vit pas viti.

Politika për arritjen e numrit optimal të punonjësve të Pushtetit Gjyqësor parashikon rritje të numrit të gjyqtarëve në funksion të analizës së kryer nga Ministria e Drejtësisë për një shpërndarje sa më të drejtë të ngarkesës së çështjeve gjyqësore për çdo gjyqtar, raporte të drejta funksionale gjyqtar/administratë mbështetëse, përmirësim cilësor të organikave të administratës gjyqësore nëpërmjet përfshirjes së punonjësve të teknologjisë së informacionit dhe punonjësve që mbulojnë marrdhëniet me median dhe publikun. Këto ndërmarje kanë efekt të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj publikut dhe rritjen e transparencës dhe efikasitetit në gjykata.

Gjithashtu në këtë rritje është parashikuar edhe rritja në muajin korrik e pagave për gjyqtarët rreth 2% si dhe për punonjësit e administratës 3-5%.

Mbështetur në buxhetin e miratuar është kryer edhe detajimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për çdo gjykatë, sipas strukturave organike të tyre.

-Për shpenzimet operative, konstatohet një rritje e buxhetit kundrejt 2010, në masën 35%. Në këtë rritje është përfshirë buxheti i nevojshëm për një aktivitet të ri të gjykatave, ruajtja me roje private e godinave, duke filluar nga data 1 janar 2011, në zbatim të V.K.M. nr.333, datë 28.04.2010 "*Për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve shtetërore*". Duke zbritur fondin për ruajtjen e godinave, rritja reale e buxhetit për shpenzime operative, kundrejt vitit 2010, është 12%. Për detajimin e shpenzimeve operative u morën në konsideratë disa faktorë si: ruajtja e standardit për zëra të njëjtë shpenzimesh të llogaritura për numër gjyqtarësh, numër çështjesh dhe sipërfaqe godine; detyrimi i gjykatave për aktivitetin e ri, ruajtjen e godinave të tyre me roje private; detyrimet e mbartura nga viti 2010; specifika të veçanta të disa gjykata etj.

-Përsa i përket investimeve, fondi i miratuar ka ulje si kundrejt kërkeses në projekt-buxhet(-40%) ashtu edhe buxhetit për vitin 2010(-8%). Në kushtet e mosakordimit të plotë të fondit të kërkuar, me qëllim detajimin e tij, është kryer rivlerësimi i parashikimeve të bëra në fazën e hartimit të projekt-buxhetit.

Në detajimin e fondit të investimeve për gjykatat është marrë në konsideratë: përfundimi i punimeve për rikonstruksionin dhe shtesën e godinës për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, investim i nisur gjatë vitit 2010; fillimin e punimeve për përshtatjen e ish-shtëpisë së oficerëve në Gjykatë të Rrethit Gjyqësor Pogradec (investim i cili për shkak të pamjaftueshmërisë së buxhetit do të shtrihet në dy vite); plotësimi pjesor i nevojave të gjykatave për pajisje elektronike, pajisje dhe mobilje për zyrat dhe sallat e gjyqit dhe elemente sigurie si dhe plotësimi i kërkesave për punime në nivel mirëmbajtje të godinave

IV.1.2 Monitorimi dhe zbatimi i buxhetit për vitin 2011

Zyra si njësi publike që monitoron zbatimin e buxhetit nga gjykatat (njësi shpenzuese të varësisë), ka monitoruar në vijimësi realizimin e shpenzimeve buxhetore në funksion të menaxhimit efektiv dhe eficient të tyre si dhe arritjes së objektivave të përcaktuara.

IV.1.2-A Mekanizmat e monitorimit

Disa nga mekanizmat e përdorur për monitorim janë:

- Situacioni mujor i shpenzimeve, nëpërmjet të cilit ndiqet realizimi i fondeve buxhetore korrente dhe kapitale.
- Raportet e monitorimit, të cilat janë 3/6/9/12 mujore, nëpërmjet të cilave identifikohen arritjet në terma sasiore dhe vlerore të produkteve të ofruara dhe shkaqet për mosrealizime.
- Raportet e realizimit të investimeve sipas objekteve të prokurimeve.
- Regjistri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike, nëpërmjet të cilit monitorohet realizimi i prokurimeve publike në gjykata.

Gjatë procesit të zbatimit të buxhetit, gjykatave u është ofruar asistencë e nevojshme, nëpërmjet hartimit të udhëzimeve të ndryshme mbi çështje që kanë të bëjnë me hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, apo çështje të tjera me efekte financiare në buxhetin e gjykatave dhe në buxhetin e pushtetit gjyqësor në tërësi.

Konkretisht gjatë vitit 2011 gjykatat janë mbështetur me:

- Udhëzimin për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2011.
- Udhëzimin për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014.
- Udhëzimin për hartimin e raporteve të monitorimit dhe realizimit të investimeve sipas prokurimeve.

- Udhëzimin “Mbi unifikimin e praktikave për punën jashtë kohës normale të punës”
- Udhëzimin për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në zbatim të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.2, datë 18.08.2011 ”Për natyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit.”

Në kuadër të Ligjit të ri nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin,, si dhe akteve plotësuese të tij, është zhvilluar një seminar me kryetarët e Gjykatave. Seminari është organizuar nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor në bashkëpunim me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, pranë Ministrisë së Financave. Qëllimi i tij është njohja e koncepteve dhe përgjegjësi të reja për menaxherët e lartë të Gjykatave, të cilat rrjedhin nga hyrja në fuqi e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010. Në këtë seminar, midis të tjerash janë trajtuar çështje të cilat kanë të bëjnë me: Zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në gjykata, si njësi publike; Përgjegjësitë direkte të Kryetarit të Gjykatës në cilësinë e Nëpunësit Autorizues etj. Në vijim këto seminare do të organizohen dhe për menaxherët e niveleve të tjera në gjykata.

IV.1.2.-B Rialokimi i fondeve

Mbështetur në informacionin e marrë nëpërmjet mekanizmave monitorues dhe vlerësues, gjatë vitit 2011, bazuar në aktet ligjore e nënligjore që lidhen me zbatimin e buxhetit, janë ndjekur politika buxhetore fleksibël dhe janë përdorur instrumenta buxhetorë, të cilat kanë patur si qëllim realizimin e plotë të buxhetit të miratuar me ligj dhe plotësimin e nevojave të paparashikuara në detajimin e kryer në fillim të vitit. Mbi këtë bazë janë kryer rialokime të fondeve buxhetore në shpenzime operative dhe investime. Gjithashtu rialokime të fondeve janë kryer edhe për shkak të rishikimit me ligj të buxhetit të shtetit në muajin korrik 2011.

i. Transferime në zërin “Shpenzime operative”

Me daljen e Ligjit nr.10450, datë 14.07.2011 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.10355, datë 02.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011” u reduktua buxheti i shtetit në tërësi në masën 18,4 miliard lekë ose 4,5% krahasuar me buxhetin fillestar. Pjesë e këtij reduktimi ishte edhe reduktimi i shpenzimeve operative për Pushtetin Gjyqësor në shumën 50 milion lekë ose 2,7% e buxhetit total të vitit 2011.

Ky reduktim bëri të vështirë realizimin në vazhdimësi të aktivitetit të gjykatave. Në reagim të kësaj situate, gjykatat paraqitën pranë Zyrës analiza të detajuara lidhur me zërat e shpenzimeve që nuk mbuloheshin nga buxheti i mbetur në dispozicion deri në fund të vitit 2011.

Nga analizat e parashtruara nga gjykatat rezultonte se, buxheti i rishikuar për shpenzime operative, nuk mund të mbulonte nevojat bazë për shpenzime si energji elektrike, ujë, shërbim postar etj., të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetin e përditshëm; shpenzimet e nevojshme për karburant, dieta për gjyqtarët e komanduar për të gjykuar në gjykata të tjera, material zyre si letër e tonera, me efekt të drejtpërdrejtë në realizimin e proceseve gjyqësore; nevojat për shpenzime për avokatë të thirrur kryesisht, shpenzime për mirëmbajtjen e godinave të gjykatave, pajisjeve dhe sistemeve elektronike të instaluar, në funksion të ruajtjes së standardeve të arritura dhe vlerës së investimeve të kryera.

Praktikisht shtesa në vlerë absolute e shpenzimeve operative, kundrejt vitit 2010, e cila u destinua për mbështetjen e aktivitetit të ri të gjykatave për vitin 2011, ruajtjen me roje private të godinave pas orarit zyrtar të punës dhe gjatë ditëve të festave dhe pushimit, ishte 50,000 mijë lekë, dhe kjo u reduktua. Në këtë mënyrë duke qenë se nuk mund të prekej ky shërbim, u prekën të gjithë zërat e shpenzimeve të listuara më sipër.

Marrë në konsideratë sa më sipër si dhe faktin që buxheti i reduktuar përbënte rreth 80% të buxhetit të detajuar për gjykatat për 3-mujorin e fundit të vitit, mosakordimi i një buxheti shtesë për shpenzime operative, do të paralizonte aktivitetin e gjykatave për këtë periudhë dhe përmbushjen e shërbimeve gjyqësore në to.

Në një analizë të mëtejshme të shpenzimeve të personelit për periudhën Janar-Gusht, rezultonte se gjykatat nuk kishin përdorur të plotë fondin e detajuar për këtë periudhë, për shkak të mosplotësimit në strukturat organike. Mungesat kanë qenë kryesisht në numrin e gjyqtarëve, për shkak se procesi i përzgjedhjes dhe emërimit të tyre kërkon vendimmarrje të disa institucioneve. Që prej fillimit të vitit, nuk janë plotësuar vendet vakant për mesatarisht 3 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë dhe mesatarisht 5 ndihmësa ligjorë të këtyre gjyqtarëve. Përsa i përket gjykatave të apelit dhe rretheve gjyqësore, numri i vendeve vakant ka ndryshuar vazhdimisht gjatë vitit dhe për të gjithë periudhën 8-mujore, ka patur mungesa për mesatarisht 6 gjyqtarë në Gjykatat e Apelit dhe 25 gjyqtarë të Gjykatave të rretheve gjyqësore.

Gjatë kësaj periudhe ka patur mungesa edhe në numrin e miratuar për administratën gjyqësore, me rreth 12 punonjës, kryesisht punonjës të teknologjisë së informacionit dhe punonjës që mbulojnë marrëdhëniet me median dhe publikun në gjykatë. Mosplotësimi i këtyre strukturave ka ardhur si rezultat i vështirësive të hasura për detajimin e numrit të punonjësve të miratuar me ligj, për Pushtetin Gjyqësor për vitin 2011. Në përpjekje për të realizuar detajimin brenda numrit të miratuar, strukturat përfundimtare u miratuan në muajin Qershor të këtij viti. Për këtë arsye, si edhe për shkak të kohës së nevojshme për kryerjen e procedurave të rekrutimit të punonjësve të administratës gjyqësore, për periudhën 8-mujore nuk u plotësuan të gjithë strukturat e lira

Me angazhimin direkt të Kryetares së Bordit dhe duke shfrytëzuar të gjithë hapësirat ligjore për menaxhimin e buxhetit të shtetit në tërësi dhe ato të Pushtetit Gjyqësor në veçanti, në negociata me autoritetet më të larta të ekzekutivit dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financave u realizua transferimi i një buxheti prej 50,000 mijë lekë nga shpenzimet për personelin në shpenzime operative, duke shkuar në këtë mënyrë në nivelin e buxhetit për shpenzime operative të miratuar në fillim të vitit.

ii. Transferime në zërin “Investime”

Nisur nga ecuria e realizimit të investimeve për periudhën janar - shtator si dhe situatat e reja të krijuara gjatë vitit, u realizuan dy rialokime të fondeve të papërdorura në investime në zërat “Projekt” dhe “Rikonstruksion”.

-Në zërin “Projekt” rezultojnë fonde të papërdorura nga Gjykata e Lartë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Gjykata e Lartë - Në fillim të vitit për këtë gjykatë u detajua fondi prej 12,300 mijë lekë, i nevojshëm për hartimin e projekt-zbatimit të godinës së re, të projektuar për t’u ndërtuar sipas programit buxhetor afatmesëm. Gjatë muajit tetor u konkludua ideja e ndërtimit të Pallatit të Drejtësisë, realizimi i të cilit është përfshirë në një nga projektet e BE-së, për sistemin gjyqësor. Projekti i Pallatit të Drejtësisë do të ketë pjesë të tij, institucionet e drejtësisë që ndodhen në Tiranë, duke filluar nga Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit, Gjykata e Rrethit, Prokuroria e Përgjithshme, etj.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier - Në fillim të vitit u detajua fondi prej 3,900 mijë lekë, për hartimin e projekt-zbatimit për godinën e re të kësaj gjykate. Gjatë vitit 2011 nuk arritën të përfundohen procedurat administrative lidhur me miratimin e sheshit të ndërtimit, e për pasojë nuk mundi të fillojnë procedurat për prokurimin e fondit të akorduar për hartim projekti.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë - U akordua fondi prej 840 mijë lekë për hartimin e projektit për rikonstruksionin e godinës së kësaj gjykate. Gjykata zhvilloi dy herë procedurat e prokurimit për këtë objekt, por nuk arriti t’i përfundojë ato.

-Në zërin “ Rikonstruksion”, rezultoi i papërdorur fondi i akorduar në fillim të vitit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër në vlerën 1,400 mijë lekë. Gjykata nuk mundi të realizojë prokurimin e këtij fondi, për shkak të mosmarrëveshjeve të bashkëpronësisë me arkivën e rrethit.

Fondet e papërdorura u rialokuan për plotësimin e:

- Plotësimin e nevojave emergjente për pajisje zyre, për shkak të transferimit të gjyqtarëve të rinj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.
- Mbylljen e investimit të nisur gjatë vitit 2010, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

- Hartimin e projektit për Dhomën Administrative të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vlerë 1,700 mijë lekë (likujdimi i vlerës 60% të këtij projekti). Në bazë të VKM Nr.444, me dorëzimin e projektit, paguhet vetëm 60% e vlerës totale të shërbimit, ndërsa pjesa tjetër prej 40%, duhet të paguhet mbas prokurimit të zbatimit, ose mbasi është mbushur një vit nga dorëzimi i projektit.
- Fondet e mbetura u transferuan në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, e cila është duke u rikonstruktuar tërësisht. Kalimi i fondeve në këtë projekt ndihmoi për një realizim të lartë në përdorimin e fondit të investimeve për vitin 2011. Gjithashtu duke qenë një projekt në vazhdim edhe për vitin 2012, zvogëlon financimin e këtij projekti nga buxheti i investimeve të vitit 2012.

IV.1.3. Ecuria e realizimit të fondeve buxhetore për vitin 2011

Realizimi i fondeve buxhetore, për Pushtetin Gjyqësor për vitin 2011, paraqitet në tabelën e mëposhtme.


Tabela nr.2

Realizimi i fondeve buxhetore për Pushtetin Gjyqësor për vitin 2011¹

në 000/lekë

Emertimi	Buxheti i miratuar për vitin 2011	Buxheti i Rishikuar për vitin 2011	Realizimi i buxhetit për vitin 2011	Raporti (në %) Realizim/Buxhet për vitin 2011
Paga	1,202,136	1,151,345	1,022,175	89%
Sigurime Shoqerore	158,864	156,174	143,834	92%
Transferime korrente të brendshme	180	180	180	100%
Transferime tek individ	0	1,057	960	91%
Shpenzime Operative	299,820	302,244	295,686	98%
Investime	165,000	165,000	158,961	96%
TOTALI	1,826,000	1,776,000	1,621,796	91%

¹ Në buxhetin e rishikuar për vitin 2011, janë përfshirë të gjitha rialokimet e kryera gjatë vitit.



IV.1.3-A Shpenzime personeli

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit, për vitin 2011, për mbulimin e shpenzimeve në paga dhe sigurime shoqërore, është 1,361,000 mijë lekë. Buxheti i rishikuar, në të cilin pasqyrohen transferimet e kryera gjatë vitit si dhe transferimet e realizuara nga vetë gjykatat për përdorimin e fondit të veçantë, është 1,307,519 mijë lekë dhe realizimi 1,166,009 mijë lekë ose 89% e buxhetit të rishikuar.

Në realizimin në masën 89% të fondit për paga dhe sigurime shoqërore kanë ndikuar disa faktorë:

- Gjatë periudhës janar-dhjetor, ka patur mosplotësime të strukturave organike në disa gjykata si: Gjykata e Lartë; Gjykatat e Apeleve: Vlorë, Durrës, Shkodër; Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda; Gjykatat e Rretheve Gjyqësore: Durrës, Dibër, Elbasan, Gjirokastër, Kavajë, Korçë, Krujë, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Tropojë, Vlorë edhe Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Gjatë vitit 2011, nuk janë plotësuar strukturat organike të gjykatave për një numër mesatar, prej 50 punonjësish.
- Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore është detajuar sipas strukturës organike të plotë të gjyqtarëve, të përcaktuar me Dekret të Presidentit. Ndërkohë që gjatë kësaj periudhe nuk janë emëruar të gjithë gjyqtarët, sipas strukturave të miratuara. Në këtë mënyrë, për këtë periudhë nuk është përdorur fondi i plotë, i detajuar për pagesën e gjyqtarëve. Numri mesatar i vendeve vakante të pa plotësuar gjatë vitit është 33 gjyqtarë.


- Pjesë e fondit të pa realizuar është edhe fondi i veçantë në masën 5% të shpenzimeve faktike, i cili për shkak të daljes të VKM nr. 472, dt. 02.07.2011 "Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011", nuk u përdor i plotë. Fondi i veçantë i përdorur gjatë vitit, përbënte 1,5% të shpenzimeve faktike për paga.

IV.1.3-B Shpenzime operative

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit, për vitin 2011, është 299,820 mijë lekë, ndërsa buxheti i rishikuar është 302,244 mijë lekë. Në buxhetin e rishikuar përfshihen edhe transferimet e kryera nga vetë gjykatat si rezultat i përdorimit të fondit të veçantë. Realizimi i këtij artikulli paraqitet në vlerën 295,686 mijë lekë ose 98% e buxhetit të rishikuar.

Me buxhetin në dispozicion për shpenzime operative për vitin 2011, është realizuar mbështetja e aktivitetit të përditshëm të gjykatave në funksion të çështjeve të gjykuara gjatë vitit, realizimi i plotë i ruajtjes së godinave të tyre me roje private, ekzekutim pjesor i vendimeve gjyqësore (7% e detyrimit total) etj.

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohen shpenzimet e realizuara nga gjykatat sipas grupeve kryesore të tyre.



Nga analiza e zërave të shpenzimeve për të cilët është përcaktuar një standart orientues si kufi maksimal shpenzimesh, rezulton se shpenzimet faktike janë brenda këtyre standardeve. Kështu shpenzimet faktike vjetore për letër janë 72 lekë/çështje, kancelari 56 lekë/çështje, tonera 138 lekë/çështje, materiale pastrimi 97.7 lekë/m², shpenzime postare 237 lekë/çështje etj.

Në reflektim të politikave të Qeverisë për menaxhimin e buxhetit, Zyra dhe gjykatat vazhdimisht kanë marrë masa në drejtim të efikasitetit dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve buxhetore, për aq sa këto masa nuk çenojnë proceset gjyqësore dhe funksionin kryesor të gjykatave. Me gjithë masat e marra, në fund të vitit 2011 rezultuan detyrime të palikujduara në vlerë 15, 862 mijë lekë ose 5% e nevojave reale të gjykatave për vitin 2011. Këto detyrime konsistojnë kryesisht në udhëtim e dieta, shpenzime postare, materiale të përgjithshme zyre, shpenzime për avokatë dhe ekspertë, mirëmbajtje pajisjesh etj. Mbartja e tyre, për vitin 2012, do të rëndojë buxhetin e gjykatave për shpenzime operative.

IV.1.3-C Investime


Fondi i investimeve, akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2011, ishte 165,000 mijë lekë dhe realizimi 158,961 mijë lekë ose 96%. Në qoftë se do të analizojmë investimet sipas projekteve rezulton situata e mëposhtme:

Tabela nr.3

Realizimi i investimeve për Pushtetin Gjyqësor për vitin 2011

në 000/lekë

Projekti	Plan	Fakt	%
Ndërtim	940	940	100%
2 .Rikonstrukcion	112,111	111,652	100%
3 .Automjete	7,000	6,965	100%
4 .Pajisje - Mobilje	41,959	38,532	92%
5 .Projekt	2,990	872	29%
TOTALI	165,000	158,961	96%



Objektivat e përcaktuara për vitin 2011, përsa i përket investimeve në gjykata, janë të fokusuar në drejtim të infrastrukturës ndërtimore, mobilimit të zyrave e sallave të gjykimit, sigurisë si dhe infrastrukturës elektronike të gjykatave.

➤ "Projekt"

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit, për këtë zë të investimeve, është 2,990 mijë lekë ndërsa realizimi është 872 mijë lekë, ose 29%. Gjatë vitit 2011, u realizua projekti për rikonstruksionin e godinës për Dhomën Administrative të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili nuk u likuidua për shkak të bllokimit nga Dega e Thesarit Tiranë, pa asnjë argument. Gjithashtu përfundoi likuidimi i vlerës 60% të projekteve të hartuara gjatë vitit 2010, për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin .

➤ "Ndërtim"

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit në projektin "Ndërtim", për periudhën janar-dhjetor, ishte 940 mijë lekë dhe realizimi është 940 mijë lekë ose 100%. Ky fond është përdorur për likuidimin e detyrimit të mbartur nga viti 2010, i cili ka të bëjë me pagesën e supervisorit për ndjekjen e punimeve të ndërtimit të godinës së re për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, ndërtim i cili u realizua në dy vite, 2009-2010.

➤ **"Rikonstruksion"**

Fondi i akorduar në projektin "Rikonstruksion", për vitin 2011, ishte 112,111 mijë lekë dhe realizimi 111,652 mijë lekë, ose 100%. Ky fond është fokusuar në dy objekte kryesore:

- Përfundimi i rikonstruksionit dhe shtesës së godinës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Vlera e investimit të realizuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për vitin 2011, kapi shifrën 74,494 mijë lekë (plani 74,500 mijë lekë), me të cilën u arrit të likuidohej vlera e mbetur për vitin 2011, sipas kontratës fillestare të sipërmarrjes, pagesat e supervizionit dhe të kolaudimit të punimeve, si dhe shtesa e kontratës, të miratuar në vlerën 11,000 mijë lekë. Investimi i realizuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka bërë të mundur shtimin e numrit të sallave të gjykimit, në funksion të nevojës së realizimit të të gjitha proceseve gjyqësore në salla gjyqi, krijimin e një ambienti të ri për marrëdhëniet me publikun, si dhe përmirësime të pjesshme në ambjentet e godinës.
- Fillimi i rikonstruksionit/përshtatjes së ish-Shtëpisë së Oficerëve Pogradec në Gjykatë të Rrethit Gjyqësor Pogradec, investim ky i shtrirë në 2 vite, 2011-2012. Vlera e investimit të realizuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, për pjesën e parë të kontratës dyvjeçare të lidhur për këtë objekt ishte 32, 571 mijë lekë. Fondi i planifikuar fillimisht për këtë gjykatë ishte 27, 986 mijë lekë dhe u rrit në 32, 571 mijë lekë, me transferimet e realizuara në fund të vitit. Në përfundim të tij, pritet që kjo gjykatë të operojë në një godinë të pajisur me katër salla gjykimi, (nga të cilat një penale dhe tre civile), të ketë një ambient të përshtatshëm të shërbimit ndaj publikut dhe një skeme funksionale të përshtatshme e në përputhje me kërkesat e kohës dhe ato të sigurisë.

Krahas fondeve të përqendruara në dy objektet, si më lart, gjatë vitit 2011 u operua edhe me fonde në vlera më të vogla, të cilat kishin si objektiv përmirësimin e kushteve të punës, nëpërmjet ndërhyrjeve të vogla konstruktive, si dhe përmbushjen e nevojave për mirëmbajtje të 6 godinave të gjykatave dhe konkretisht në: Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit Durrës, Gjykatën e Apelit Vlorë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Me investimet e parashikuara gjatë vitit 2011, mendohej të arrihej përmirësimi i infrastrukturës ndërtimore në 60% të gjykatave ose në 19 godina. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec e parashikuar të përfundohej brenda vitit 2011, nuk arriti të realizohej për mungese fondesh, prandaj u shtri në dy vite kryerja e punimeve dhe pritet të përfundohet brenda vitit 2012. Për rrjedhojë përqindja e arritur është 58%.

➤ **"Pajisje Mobilje"**

Fondi i akorduar nga Buxheti i Shtetit, për vitin 2011, në projektin "Pajisje" është 41,959 mijë lekë dhe realizimi 38,532 mijë lekë ose 92%. Këtu përfshihen fondet e nevojshme për mobilimin

e zyrave, sallave të gjykimit dhe ambienteve të tjera ndihmëse në gjykatë, investimi në drejtim të instalimit të elementëve të sigurisë si dhe infrastrukturës elektronike.

- a. Pajisje dhe Mobilje - Sjellja e infrastrukturës së gjyqësorit në parametrat dhe cilësinë e performancës së ngjashme me vendet e Bashkimit Evropian, ka qenë vazhdimisht në vëmendje të Zyrës gjatë ndërmarrjes së projekteve të ndryshme investuese. Investimet e realizuara në gjykata gjatë vitit 2011 kanë synuar arritjen e objektivave të përcaktuara nëpërmjet: mobilimit të zyrave e sallave të gjyqit, sigurimit të solemnitetit të gjykimit dhe sigurisë së punës në gjykata. Gjatë vitit 2011 është investuar në drejtim të mobilimit të ambienteve dhe instalimit të elementeve të sigurisë në 20 gjykata. Me buxhetin e akorduar për vitin 2011 janë plotësuar nevojat e gjykatave kryesisht për mobilim të zyrave të gjyqtarëve dhe administratës, pajisjen e sallave të gjyqit me elemente të solemnitetit si: vendqëndrim për dëshmitarët apo ekspertët të thirrur për të qenë të pranishëm gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore si dhe me sistem fonie dhe pajisje të tjera. Investimet në gjykata kryhen sipas një standardi të caktuar. Bazuar në këto standarde me investimet e realizuara, në fund të vitit 2011 rezultojnë të plotësuara me pajisje-mobilje 100% sipas standardit, 20 gjykata ose 64% e tyre. Pjesa tjetër e gjykatave, prej 36% janë të plotësuara me pajisje dhe mobilje, por arritja e standardeve në to, lidhet me kohën e kryerjes së ndërhyrjeve në infrastrukturën ndërtimore të tyre, sipas prioriteteve. Ndërtimi i godinave të reja, apo rikonstruksioni që shoqërohet me krijimin e ambienteve të reja për shërbimin ndaj publikut në gjykata, rritja e numrit të zyrave apo sallave të gjyqit, sjellin nevojen e investimeve për kompletimin e tyre.

Koncepti i sigurisë së gjykatave është tepër i gjerë dhe përfshin në vetvete idenë që të gjitha palët, që përfshihen në një proces gjyqësor, të jenë të sigurta gjatë gjithë kohës që ato ndodhen në gjykatë për zhvillimin e procesit gjyqësor. Në këtë kontekst, paraqet rëndësi të veçantë siguri i pajisjeve të domosdoshme për sigurinë në gjykata. Të tilla pajisje janë: dera e dedektimit (instalimi i këtij elementi të sigurisë në hyrjen e publikut bën të mundur shmangien e futjes së personave të pajisur me elemente të ndryshëm që janë të rrezikshëm dhe nuk duhet të jenë prezent në sallat e gjyqit); hyrja me kartë (një tjetër element i sigurisë i instaluar zakonisht në hyrjen e personelit duke limituar flukset hyrëse në gjykate); aparat dore për kontrollin e armëve; kamera etj. Gjatë vitit 2011 është investuar për plotësimin kryesisht me derë dedektimi dhe kamera në 6 gjykata. Deri tani rezultojnë të plotësuara me elemente sigurie rreth 64% e gjykatave. Theksojmë se realizimi i investimit në elementet e sigurisë është i lidhur ngushtë me godinën në aspektin ndërtimor të saj, me skemën e brendshme funksionale dhe menyrën e organizimit të shërbimeve. Pra investimet për instalimin e hyrjeve me kartë apo dyerve të dedektimit lidhen ngushtësisht me planin e investimeve për përmirësimin e infrastrukturës ndërtimore në gjykata.

Me investimet e realizuara gjatë vitit 2011, është arritur të mobilohen rreth 64% e gjykatave. Përsa i përket sigurisë, objektivi ka pasur qëllim plotësimin me elemente të sigurisë deri në 70 % të gjykatave. Për shkak se gjatë vitit 2011, filloi aktivitetin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, u rrit numri i gjykatave ku duhej investuar në drejtim të sigurisë dhe për rrjedhojë përqindja e realizimit u ul në 64%.

- b. Pajisje elektronike - Infrastruktura elektronike është një element mjaft i rëndësishëm i investimeve që janë të detyrueshme për t'u kryer çdo vit. Këtu përfshihen investimet për mbajtjen në një nivel të caktuar të gjendjes të kompjuterave për mbështetjen e programit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, si dhe shtesat e reja që lindin nga aplikimi i projekteve të reja në shërbim të transparencës dhe informimit të publikut. Si rezultat i investimeve të kryera është arritur një përmirësim i dukshëm i kësaj infrastrukture dhe në fund të vitit 2011, rezulton plotësimi në masën 90% i gjykatave me pajisje elektronike, në gjendje të mirë punë. Përqindja e lartë e amortizimit vit pas viti bën që nevojat në këtë drejtim nuk mund të plotësohen 100% . Përveç kësaj çdo vit janë aplikuar dhe do të vazhdojnë të aplikohen projekte të reja në kuadër të rritjes së transparencës të proceseve gjyqësore të cilat sjellin një rritje të kërkesave për pajisje elektronike. Këtu mund të përmendim projektin e ndërmarrë në gjykata për mbajtjen në formë elektronike të procesverbaleve gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, vendosjen e monitorëve në sallat e gjyqit dhe brenda ambienteve të gjykatave në zonën e marrëdhënieve me publikun, vendosjen dhe instalimin e sistemeve audio të regjistrimit, (projekt ky i filluar nga projekti JUST). Gjithashtu edhe projekti i menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS, i instaluar në gjykata kërkon investime të vazhdueshme në infrastrukturën elektronike për të bërë të mundur funksionimin normal në mënyrë të pandërprere të tij. Të gjitha këto projekte të reja kërkojnë mbështetje për vazhdimësinë e tyre nëpërmjet investimeve të vazhdueshme në infrastrukturën elektronike.

IV.1.4 Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014

Prej 4 vitesh, Pushteti Gjyqësor është pjesë e hartimit të programeve buxhetore afatmesme. Hartimi i kërkesave buxhetore kryhet mbështetur në Deklaratën e Politikës së Programit (DPP) i cili është dokumenti bazë për planifikimin e shpenzimeve buxhetore. Në këtë dokument, përcaktohet politika, qëllimi që synohet të arrihet, objektivat afatmesme dhe afatshkurtra në funksion të arritjes së këtij qëllimi si edhe standardet mbi të cilat do të mbështeten këto objektiva. Më pas çdo objektivi, zbërthehet në produktet të cilat do të realizohen në funksion të arritjes së objektivave si dhe aktivitetet që do të ndërmerren për realizimin e tyre. Pra, siç vihet re, ky proces nuk është thjesht një proces teknik, i bazuar vetëm mbi statistika apo tendenca të shpenzimeve, por hartohet mbi bazë të një metodologjie të caktuar dhe është gjithëpërfshirës.

Ky proces udhëhiqet nga Grupi për Buxhet Strategji dhe Integrim (GSBI), ose Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS).

Gjatë vitit 2011, është hartuar Projekt Buxheti Afatmesëm për Pushtetin Gjyqësor për periudhën 2012-2014, proces i cili u realizua në dy faza: në muajin maj dhe muajin gusht. Në funksion të këtij procesi, në muajin mars gjykatave iu dërgua udhëzimi për hartimin e kërkesave buxhetore dhe deklarata e politikës së programit si dokumenti bazë mbi të cilin do të mbështetej rishikimi i politikave dhe objektivave dhe hartimi i kërkesave buxhetore për vitin 2012. Për 11 nga 52 zërat e shpenzimeve operative, gjykatave iu dërguan edhe standarde orientuese për hartimin e kërkesave buxhetore. Projekt-buxhetet e paraqitura nga gjykatat, u rishikuan nga specialistët e Zyrës, anëtarë të EMP (Ekipi i Menaxhimit të Programit) dhe pas miratimit hap pas hapi nga GSBI (Grupi për Strategji, Buxhet, dhe Integrim). PBA 2012-2014 për Pushtetin Gjyqësor, u dorëzuan në Ministrinë e Financave, brenda datë 1 maj, afatit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.8 date 02.03.2011 "Për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe fondet speciale", për përmbylljen e fazës së parë të këtij procesi. Ky proces, përfundoi në fazën e dytë të tij, në muajin gusht, sipas përcaktimeve në aktet ligjore e nënligjore në këtë drejtim.

Kërkesat buxhetore për periudhën 2012-2014 paraqiten në tabelë.

Tabela nr.4

Kërkesat buxhetore për Pushtetin Gjyqësor 2012-2014

në 000/lekë


Emertimi	Viti 2012		Viti 2013		Viti 2014	
	Tavani i miratuar nga MF	Kërkesa në PBA	Tavani i miratuar nga MF	Kërkesa në PBA	Tavani i miratuar nga MF	Kërkesa në PBA
Shpenzime personeli	1,363,000	1,430,976	1,412,000	1,430,976	1,461,000	1,461,000
Shpenzime operative + 606	255,000	329,345	263,000	345,000	273,000	363,000
Investime	180,000	362,495	190,000	596,224	210,000	512,407
TOTAL	1,798,000	2,122,816	1,865,000	2,372,200	1,944,000	2,336,407

Sa i përket vitit 2012, situata buxhetore paraqitet si më poshtë.

Tabela nr.5
Buxheti për Pushtetin Gjyqësor për vitin 2012

000/leke

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar per vitin 2011	Kërkesa në PBA per vitin 2012	Buxheti i miratuar per vitin 2012	Raporti (%) Buxheti 2012/ Buxheti 2011	Raporti (%) Buxheti 2012/Kërkeses PBA 2012
1	Shpenzime personeli	1,311,000	1,430,976	1,326,611	+1%	-8%
2	Shpenzime operative	299,820	329,165	281,612	-6%	-15%
3	Transferta për buxhetet Familiare dhe individët	180	180	180		
4	Investime	165,000	362,495	180,000	+9%	-50%
	TOTALI	1,776,000	2,122,816	1,788,403	+ 0.6%	- 16%



Miratimi i buxhetit për vitin 2012, kaloi në disa faza, duke filluar nga negociatat me Ministrinë e Financave në muajt maj dhe shtator e deri në mbrojtjen e tij në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Në këto takime, përfaqësues të Bordit Drejtues dhe Zyrës kanë parashtruar argumentet përkatës mbi domosdoshmërinë e rritjes së mëtejshme të buxhetit për Pushtetin Gjyqësor. Si rezultat i negociatave të zhvilluara dhe argumenteve të paraqitura, u rrit numri organik i punonjësve të miratuar me ligj, me 15 punonjës. Gjithashtu u sigurua një rritje e buxhetit për shpenzime operative në vlerë 26,000 mijë lekë, kundrejt tavanit paraprak të propozuar nga Ministria e Financave, gjatë procesit të hartimit të kërkesave buxhetore afatmesme.

Përsa i përket investimeve, buxheti i miratuar është në nivelin e tavanit të përcaktuar nga Ministria e Financave dhe nuk pësoi rritje të mëtejshme të tij. Akordimi jo i plotë i buxhetit të kërkuar për investime, në këto vite, ka cënuar ritmin e realizimit të investimeve të parashikuara, duke ndikuar në këtë mënyrë në rritjen e kërkesave buxhetore në vitet pasardhëse. Mosplotësimi në vazhdimësi i nevojave vjetore për investime, do të shtyjë në kohë, realizimin e Politikës së Programit, përtej vitit 2015.

IV. 2. Standardizimi i Shpenzimeve

Rezultatet konkrete të standardizimit të shpenzimeve shihen si një mjet për të lehtësuar punën për menaxhimin e burimeve buxhetore. Siç e kemi theksuar dhe më sipër ZABGJ në rolin e saj si menaxhuese, monitoruese dhe vlerësuese e shpenzimeve të gjykatave, tashmë nëpërmjet standardeve të brendshme të përkohshme ka një mjet më shumë për të ushtuar funksionet e saj. Nëpërmjet diagrameve të profilizimit dhe analizës së efikasitetit mund të kontrollohen shpenzimet e kryera për zërat e shpenzimeve operative të marra në analizë, duke i krahasuar me standardin e përcaktuar dhe duke parë devijimin nga standardi për çdo zë për çdo gjykatë. Praktikisht, të gjithë zërat mund dhe duhet të standardizohen pasi kjo çon drejt standardizimit të plotë të shpenzimeve operative të gjykatave.

Puna për Standardizimin e shpenzimeve gjatë vitit 2011 është fokusuar në përmbushjen e objektivave të përcaktuara .

Objektivat dhe realizimi i tyre është si më poshtë vijon:

Objektivi 1 - Standardizimi i shpenzimeve operative të gjyqësorit në masën 70% të tyre

Që në fillim të vitit 2011 janë qartësuar dhe përcaktuar llojet e shpenzimeve që do të merren në analizë, në mënyrë që të bëhet i mundur klasifikimi i njehsuar i shpenzimeve në të gjitha gjykatat e vendit. Zërat e shpenzimeve që u morën në analizë për vitin 2011 janë: Shpenzime Energji elektrike; Shpenzime Kancelarie; Shpenzime Letër; Shpenzime materiale pastrimi; Shpenzime Mirëmbajtje Ndërtesa; Shpenzime Mirëmbajtje Pajisje Elektronike; Shpenzime Postë;

Shpenzime Telefon Fiks; Shpenzime Transporti; Shpenzime Udhëtime/dieta; Shpenzime Ujë. Këto zëra dhe nen-zëra të shpenzimeve operative zënë peshën më të madhe të buxhetit të shpenzimeve operative në tërësi, në një masë prej 78%. Për këto zëra dhe nen-zëra të shpenzimeve operative u bë i mundur standardizimi.

Objektivi 2 - Kursimi i burimeve Financiare të Gjykatave

Në funksion të përmbushjes së këtij objekti, nga analisti janë modeluar standardet e brendshme të përkohshme për vitin 2011. Këto standarde, pas miratimit nga Drejtori i Zyrës, i janë përcjellë sektorit të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit. Gjithashtu duhet të përmendim se parashikimi i buxhetit, për vitin 2011-2012, në lidhje me zërat e shpenzimeve të analizuar në analizën e standardizimit, është kryer duke u bazuar edhe në standardet e përcaktuara.

Mbledhja e të dhënave për analizën e standardizimit të shpenzimeve është realizuar në kohë sipas afateve të përcaktuara në fillim të çdo tre-mujori për periudhën paraardhëse. Përpunimi i të dhënave, për të realizuar analizën e standardizimit, është kryer çdo 3, 6, 9 dhe 12 muaj duke qenë në të njëjtën linjë edhe me monitorimet e shpenzimeve të buxhetit që realizohen nga zyra e buxhetit të ZABGJ-se.

Analiza e të dhënave çdo 3 muaj gjatë vitit është e dobishme për disa arsye: 1. Tregon për shpenzimet e tepërta që janë bërë dhe masat që duhen marrë për të shmangur shkaqet e këtyre mbishpenzimeve; 2. Kontrollon se sa janë respektuar standardet; 3. Tregon se si është bërë parashikimi i artikujve që duhen përdorur në planin e vitit pasardhës, pasi mesi i vitit është koha kur dorëzohen projekt-buxhetet për vitin pasardhës.

Analizat 3, 6, dhe 9 mujore janë kryer në bazë të të dhënave të shpenzimeve fakt për periudhën 3, 6 dhe 9 mujore të vitit 2011, për zërat dhe nën-zërat e shpenzimeve operative të marra në analizë.

Gjatë këtyre analizave 3, 6, 9 mujore është vënë re se shpenzimet e gjykatave, për zërat e shpenzimeve operative të marra në analizë, kanë qenë në përputhje me standardet e përcaktuara dhe vetëm në disa raste ka patur në dukje risk për mbishpenzime, sidomos në rezultatet e analizës së 3-mujorit të parë. Por kjo situatë është përmirësuar dhe në përfundim të tyre mund të themi që gjykatat bazohen dhe respektojnë standardet e vendosura nga ZABGJ-ja.

Duhet të saktësojmë se analiza 12 mujore kryhet mbi bazën e të dhënave të vitit paraardhës, që do të thotë se gjatë vitit 2011 është kryer analiza e të dhënave për shpenzimet fakt të vitit 2010 për zërat dhe nën-zërat e marrë në analizë.

Përsa i përket analizës vjetore të realizuar në tremujorin e parë të vitit 2011, me të dhënat e shpenzimeve operative fakt, të vitit 2010, mund të themi se ka patur përmirësim në menaxhimin e fondeve buxhetore për zërat e shpenzimeve operative të marra në analizë, gjë që duket qartë nga rritja e nivelit të standardizimit, nga 45% në 57%.


Objektivi 3 - Rritja e transparencës në menaxhimin e buxhetit në gjykata

Gjatë vitit 2011 është realizuar dhe përfunduar vizatimi i profileve të standardizimit dinamik të cilët lejojnë dhe i japin mundësi Zyrës për të vlerësuar shkallën e standardizimit të zërave të përzgjedhur të shpenzimeve operative si dhe krahasimin e këtij standardizimi nga njëri vit tek tjetri.

Siç e përmendëm edhe më sipër mesatarja e standardizimit të shpenzimeve operative në gjykata, për zërat e analizuar, është rritur nga 45% në vitin 2009 në 57 % në vitin 2010.

Në mënyrë të detajuar e paraqesim me grafikun e mëposhtëm.

Renditja e Shkallës së Standardizimit për 30 Gjykata (2009-2010)



Në përfundim të analizës së kryer zërat dhe nën-zërat e shpenzimeve operative të marra në analizë për vitin 2010, siç shihet edhe nga grafiku, rezultoi se 18 gjykata janë mbi nivelin mesatar të standardizimit, nga të cilat 16 prej tyre kanë nivel shumë të lartë standardizimi. 5 prej gjykatave janë shumë afër nivelit mesatar të standardizimit dhe vetëm 3 gjykata kanë standardizim nën nivelin 20%. Por duhet të theksojmë se mesatarja e standardizimit në sistemin gjyqësor është rritur krahasuar me një vit më parë (2009) nga 45 % në 57% për vitin 2010.

Ky është një tregues që sjell në vëmendje punën e mirë të bërë nga gjykatat për menaxhimin e mirë të fondeve si dhe të Zyrës nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të aktivitetit të tyre financiar.

Të gjitha rezultatet e analizës janë përfshirë në një raport vjetor të paraqitur dhe miratuar nga Drejtori i Zyrës.

Përfundimet e analizës njëvjeçare (2010) ju janë bërë me dije gjykatave në mënyrë që secila prej tyre të njihet me pozicionin e saj kundrejt gjithë gjykatave të tjera. Kjo mundëson marrjen e masave të duhura për përmirësimin e standardizimit në to.

Objektivi 4 - Bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm në fushën e administrimit të buxhetit gjyqësor.

Në këtë drejtim është marrë pjesë në takimet e zhvilluara midis përfaqësuesve të projektit JUST dhe përfaqësuesve të USAID dhe Drejtorit të ZABGJ-së. Gjithashtu është mbajtur korrespondencë e vazhdueshme lidhur me plotësimin e kërkesave të projektit për informacione më të detajuara.

IV. 3. Aktiviteti Juridik

-Gjatë vitit 2011, Zyra është përfaqësuar si palë në 6 proçese gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për gjyqtarët ndaj të cilëve janë aplikuar masa disiplinore nga KLD. Nga këto, 3 çështje kanë përfunduar dhe 3 janë në proçes gjykimi.

-Në zbatim të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij, nga Zyra janë realizuar këto procedura prokurimi me objektet përkatëse:

- Sigurimi i jetës dhe pronës për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Apelit për Krimet e Rënda.
- Përshtatja e ish-shtëpisë së oficerave në Gjykatë të Rrethit Gjyqësor Pogradec.
- Hartimi i projekt zbatimit për përshtatjen e godinës së ish Institutit të Kërkimeve Zooteknike në godinë të Dhomës Administrative.

-Në vazhdimësi të procedurave të prokurimeve janë hartuar kontratat publike, që janë lidhur me operatorët fitues si dhe është kryer ndjekja e realizimit të tyre.

-Janë zhvilluar procedurat e ankandit për shitjen e autoveturës në pronësi të Zyrës, tip Hyundai sonata me targa TR 9660 G. Procedurat për këtë ankand u zhvilluan dy herë, por nuk arriti të realizohet shitja e tij me ankand, për mungesë konkurrence. Bazuar në VKM nr. 1242, datë 16.12.2009 “Për rregullat e funksionimit të komisionit të ankandit, procedurat e zhvillimit të ankandit, kriteret e vlerësimit të pronës që nxirret në ankand, si dhe për mënyrën e indeksimit të përfitimit financiar mujor“, mjete i pashitur kaloi në rezervat e shtetit.

-Eshte punuar për hartimin e Draft - Rregullores së re të Zyrës.

-Gjatë vitit 2011, u është ofruar asistencë gjykatave, në njohjen dhe zbatimin e paketës së re ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në Njësitë Publike.

IV. 4. Auditimi

Raporti Vjetor mbi Veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm të Buxhetit Gjyqësor fokusohet në drejtimet e mëposhtme:

Së pari: Komunikon rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm publik ne gjykata.

Raporti përçon problemet më të rëndësishme të identifikuar dhe të trajtuara, tregon ecurinë drejt përmirësimeve të vazhdueshme dhe veprimeve korrigjuese, si dhe sfidat dhe përpjekjet e pandërprera për të siguruar pajtueshmërinë me kuadrin legjislativ të parashikuar në aktivitetin ekonomik e financiar të gjyqësorit.

Së dyti: Ky raport paraqet përgjegjshmërinë e realizimit programit të auditimit. Ai trajton menaxhimin e burimeve, treguesit dhe matësit e performancës dhe shkallën e pajtueshmërisë me standardet profesionale të auditimit. Në këtë këndvështrim, raporti është në pajtueshmëri me kërkesën për përgjegjshmëri dhe reformat që qeveria po kryen në sektorin publik në Shqipëri dhe implementimi nga Bordi Drejtues i ketyre vendimeve.

Rezultatet dhe produktet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm janë të pasqyruara në raportet e auditimit të dërguar çdo gjykate.

Raporti përshkruan statusin, autoritetin, strukturën organizative dhe burimet e njësisë të auditimit, ai përvijon procesin e planifikimit mbi bazë risku si një risi të përdorur si fillim në 2011 dhe do të konsolidohet në 2012 gjatë veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

IV.4.1. Metodologjia

Raporti është mbështetur në manualin e auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe punën e bërë gjatë vitit 2011.

Njësia e auditimit të brendshëm punon në zbatim të ligjit Nr.9720, datë 23.04.2007 *”Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”* dhe ushtron veprimtarinë e saj audituese brenda autoritetit, objektit dhe sipas përgjegjësiave e të drejtave të parashikuara në këtë ligj dhe kuadrit rregullator në fuqi.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm, e fokusuar në vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të qeverisjes, jep siguri të arsyeshme nëse:

- informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacionale janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;
- burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;
- asetet janë ruajtur;
- veprimtaritë e gjykatave janë në pajtueshmëri me politikën, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara;
- objektivat kryesore të përcaktuara në programet dhe planet do të arrihen.

IV.4.2. Përgjegjshmëritë dhe strategjia e auditimit të brendshëm

IV.4.2.1. Përgjegjshmëritë

Struktura e auditimit të brendshëm përmbushin përgjegjshmëritë e tyre sikurse përcaktohen në Ligjin për Auditimin e Brendshëm, Manualin e Auditimit, Kartën dhe Kodin e Etikës për audituesit nëpërmjet implementimit të Planit Vjetor i cili përcakton qartë objektivat për t’u arritur, treguesit e matjes së performacës së auditimit, kapacitetet në dispozicion si dhe vlerësimin e menaxhimit të riskut.

Kuadri, ligjor dhe procedural i auditimit të brendshëm përfaqësohet nga:

- Ligji Nr.9720, datë 23.04.2007 *”Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”* me ndryshimet në shtator 2010.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.640, datë 11.06.2009 *”Për miratimin e Letër Politikave të KBFP dhe planit të veprimit të Brendshëm dhe të Kartës së Auditimit të Brendshëm Publik”*
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.806, datë 06.12.2006 *”Për miratimin e metodologjisë së auditimit financiar”*;

- Manulin e Auditimit të brendshëm publik
- Kuadrin e Praktikave Profesionale Ndërkombëtare, i cili përmban Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Praktikave Profesionale të publikuara nga IIA.

Dokumentet janë udhëzuesit kryesorë për krijimin dhe zhvillimin e një sistemi modern të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Shqipëri, si një nga kërkesat themelore për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

IV.4.3. Rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm

IV.4.3.1. Analiza e programeve të auditimit të brendshëm 2011

Plani Vjetor i Auditimit

1. Objektivat vjetorë të Auditimit

2. Përmbledhje e veprimtarisë së auditimit të pushtetit gjyqësor, treguesit.

Identifikimi i objektivave vjetorë afatshkurtëra të çdo gjykate, një analizë e veprimtarisë së saj gjatë vitit aktual ushtrimor si dhe pritshmëritë e fundvitit, si dhe aktivitetit i strukturës së AB, do të jenë hapat e parë në fillimin e programimit vjetor për AB të viteve pasardhëse.

Në të gjitha Gjykatat duke filluar nga Gjykata e Lartë dhe deri në gjykatat e shkallës së parë kemi gjetur gatishmërinë dhe vlerësimin e drejtuesve për zbatimin rekomandimeve.

Realizimi i planit të auditimit 2011 sipas llojit dhe periudhës së kryerjes si dhe kontrolli dhe sigurimi i cilësisë.

- Në zbatim të Ligjit nr.8363, datë 1.7.1998 *“Për krijimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor”*, neni 9, Ligjit nr.9720, datë 23.4.2007 *“Mbi Auditin e Brendshëm Publik”* Auditimi i Zyrës ka realizuar auditimin në bazë të programit vjetor të auditit të miratuar në Bord për vitin 2011.
- Në zbatim të pikës 5 të nenit 18, të Ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*, të ndryshuar me Ligjin nr.10318, datë 16.09.2010 dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm Publik të miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr.69, datë 29.09.2010 *“Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”*, Seksioni IV, pika 4.7 e tij *“Raportet periodike dhe raporti vjetor i AB”*, Njesia e Auditimit të Brendshëm ka përgatitur dhe ju paraqet Raportin periodik, për vitin 2011.

Në mënyrë të përmbledhur rezultatet e saj paraqiten sa më poshtë vijon:

IV.4.3.1.A. Organizimi, përbërja dhe funksionimi i strukturave të auditimit.

Numri i punonjësve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm është dy auditë. Struktura organizative duhet të shtohet dhe me një audit tjetër, sipas kërkesave ligjore të reja për auditin për realizimin e kontrollit të cilësisë si detyrim ligjore. Jemi në rrugën e zgjidhjes pasi kemi përkrahjen strukturave të drejtimit dhe mendojmë se do ta zgjidhim në vitin 2012.

Struktura aktualisht përbëhet:

Drejtues i Njesise - një audit
Inspektor - një audit

IV.4.3.1.B. Hartimi dhe realizimi i programeve të auditit.

Në zbatim të kërkesave të nenit 7, të Ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik», ndryshuar me Ligjin nr.10318, datë 16.09.2010 dhe të Kapitullit III të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr.69, datë 29.09.2010 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, auditimi i ushtruar ka synuar të përfshijë ato subjekte të auditimit, të cilat lidhen me misionin dhe qëllimin për të cilën ai funksionon.

Bazuar në planin vjetor, për vitin 2011, u parashikuan 18 auditime. Ky numër auditimesh u përcaktua pasi u mendua se struktura do të shtohet edhe me një audit.

Nga 18 auditime të planifikuara kemi realizuar 15 auditime. Ngelen pa u audituar Gjykata e Apelit Shkodër, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, Gjykata e Rrethit Gjirokastrë dhe Gjykata e Rrethit Tropojë, ndërsa Gjykata e Rrethit Krujë do të auditohet këtë vit.

Mosrealizimi ka ardhur si rezultat i zbatimit të standardeve të reja të auditimit, mungesës së strukturës me një audit. Nga përllogaritjet e ngarkesës për çdo auditim, kanë rezultuar mesatarisht për rreth 7 objekte të audituara për audit.

Drejtuesi i Njesisë po kryen edhe funksionin e auditit.

Bazuar në pikën 1.5.2 të Kapitullit I të Manualit, veprimtaria audituese është orientuar në: auditimin e sistemeve dhe vlerësimin në thellësi të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, të vendosura nga niveli i menaxhimit, Bordi Drejtues dhe kryetarët e Gjykatave.

Auditi ka si qëllim përcaktimin e funksionimit të tyre me kosto efektive, në mënyre efëçente, me qëllim arritjen e objektivave të gjyqësorit në fushën e administrimit publik dhe ekonomik.

Është kryer një angazhim auditimi i pjesshëm, jashtë Planit Vjetor të veprimtarisë në Gjykatën e Lartë me kërkesë të Kryetares së Gjykatës së Lartë dhe miratim të strukturës së auditit.

IV.4.3.1.C. Zbulimet e shkeljet ligjore dhe dëmet e shkaktuara

Gjatë procesit të auditimit të brendshëm, menaxhimi është informuar mbi gjetjet e auditimit. Raportimi i gjetjeve të punës tek menaxhimi i Gjykatave dhe lënia e rekomandimeve për të përmirësuar funksionimin e gjykatave është një nga pjesët më të rëndësishme të procesit të auditimit të brendshëm.

Për periudhën raportuese, gjetjet e evidentuara dhe të paraqitura në pasqyrat përkatëse, paraqesin zbulimet dhe evidentimet e raportuara nga auditimet e kryera për vitin 2011. Pas dërgimit të raportit final, në çdo gjykatë, kemi informuar Titullarin mbi përfundimin e çdo misioni auditues. Nga gjykatat kemi patur reagime pozitive, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.

Më konkretisht: Vlera e përgjithshme e gjetjeve për shkeljet financiare nga angazhimet e auditimeve për 2011, rezulton në shumën 3.680 mijë lekë.

Të ndara sipas sistemeve/fushave këto gjetje rezultojnë përkatësisht:

- Në fushën e pagave, në shumën 1.066 mijë lekë.
- Në fushën e shpenzimeve operative, për shpenzimet e kryera për pagesa avokatie, në shumën 345 mijë lekë, prokurime 1.488 mijë lekë (në Gjykatën e Rrethit Lezhë).
- Në fushën e taksave 790 mijë lekë
- Në fushën e qeradhënies të pronës publike nuk ka dëm ekonomik.
- Në auditimet e kryera pas këtij raportimi, në sistemin gjyqësor nuk kemi konstatuar shkelje të V.K.M. nr.472, datë 2.07.2011 “Mbi përdorimin e fondeve buxhetore” sipas germave “c”, “ç” dhe “d”.
- Këtë fakt e kemi të trajtuar në kapitullin e gjetjeve të çdo raporti auditimi të realizuar gjatë kësaj periudhe.

Bazuar në gjetjet e rezultuara sipas auditimeve me bazë sistemi, pranë gjykatave të audituara, për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe të organizimit të kontrollit të brendshëm, për periudhën janar-dhjetor 2011, për përmirësimin e sistemeve janë dhënë gjithsej 95 rekomandime, si vijon:

1. Sistemet organizative.
2. Sistemin e planifikimit dhe zbatimit të Buxhetit dhe pagesave.
3. Sistemin e prokurimit dhe blerjet e vogla dhe zbatim kontratash.
4. Sistemin e kontabilitetit dhe raportimit publik.

Të gjitha këto rekomandime janë dhënë në bashkepunim me kryetarët e gjykatave. Gjithashtu theksojmë faktin se për këtë periudhë, Njësia AB është marrë edhe me implementimin e Manualit të ri të Auditimit të Brendshëm, duke përshtatur procedurat e reja si dhe po bëhet hartimi i Kartës së Auditimit të Brendshëm shoqëruar nga Kodi Etik dhe Manuali Specifik i Auditimit, për gjyqësorin, të cilin ia kemi dërguar Titullarit të Bordit.

Në zbatim të shkresës nr.11907, datë 15.07.2011 të NJQH/AB, është bërë gati Manuali i Auditimit për miratim në Bordin Drejtues.

Rekomandimet e dhëna kanë qenë kryesisht të karakterit ligjor, organizativ dhe për zhdëmtim. Konstatojmë se kemi patur mbështetje nga drejtuesit e subjekteve të audituar në lidhje me pranimin dhe zbatimin e rekomandimeve të kërkuar dhe të dhënë.

Në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare kemi patur si synimin uljen në maksimum të mundësisë së përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen.

Pas çdo përfundimi auditimi kemi informuar Kryetaren e Bordit për përfundimin dhe rezultatet e auditimit.

4. Rreziqet e mundshme në kushtet e realizimit të programit vjetor

Ndonëse ndërmeren iniciativa të rëndësishme, për të realizuar funksionimin normal të gjykatave, veprimtaria gjatë aktivitetit të tyre parashikohet të jetë e shoqëruar edhe me risqe të fushës. Në përmbushjen e objektivave dhe programit të saj, struktura e AB ka parë me interes dhe njohjen e risqeve nga të cilat si më të mundshmit vlerësohen të jenë:

- Niveli i kualifikimit, aftësitë profesionale të stafit të strukturës së AB.
- Procedurat e domosdoshme për miratimin dhe hyrjen në fuqi të akteve ligjore e nënligjore (qarkullimi i dokumentacionit apo vonesat) të cilat kërkojnë kohë të konsiderueshme për ndjekje dhe zbatim.
- Burimet njerëzore dhe sigurimi i bazës së nevojshme me burime materiale dhe njerëzore për kryerjen normale të veprimtarisë.

5. Burimet e AB dhe cilesia

Në realizimin e misionëve të parashikuara, sa më sipër, sistemi i auditimit do të përdorë burimet njerëzore e materiale të vëna në dispozicion nga Zyra dhe Bordi.

Çdo raport auditimi është një produkt publik dhe si i tillë duhet të certifikohet.

Për vetë strukturën e auditimit ne nuk mund të realizojmë një kontroll të cilësisë.

Problemet që kanë rezultuar dhe që duhen zgjidhur për vitin 2012

1. Në lidhje me investimet e komunitetit Europian, kërkohet që këto investime të shkojnë atje ku nevojat janë realisht të prekshme, dhe duhet të ketë një koordinim detyrues ligjor midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Bordit Drejtues të ZABGJ-së.
2. Investimet e ndërtimit dhe projekteve duhet të bëhen nga Zyra, pasi ajo ka kapacitete më të plota për prokurim. Mjafton rasti i Gjykatës së Vlorës, dhe problemet që krijoi investimi për Zyrën dhe Bordin, për të kuptuar rëndësinë e këtij problemi.
3. Në lidhje me fondet dhe donacionet, që i jepen Pushtetit Gjyqësor, ato duhet të kalojnë vetëm nëpërmjet Zyrës dhe Bordit.
4. Duhet të kërkohen fonde buxhetore ose donacione për projektet e gjykatave që janë gati për investim si: Gjykatat e Shkodrës, Elbasanit dhe Kurbinit.
5. Rritjen e kontrollit financiar në gjykata në lidhje me të ardhurat e realizuar nga tarifat e shërbimit gjyqësor sidomos pjesës së dhënies së vendimeve gjyqësore.
6. Arkëtimi i dëmeve ekonomike, nga mosmbledhja e taksave të shërbimit gjyqësor, është një problem që kërkon zgjidhje ligjore sidomos për gjyqet të cilat kanë marrë formë të prerë, që janë në apel apo dhe në Gjykatë të Lartë. Duhet të përcaktohet autoriteti përgjegjës për vjeljen e detyrimeve.
7. Administrimi i karburanteve për makinat dhe përcaktimi i normativave në gjykata është një problem që duhet zgjidhur.
8. Inventarizimi teknik i autovecurave dhe nxjerrja e autovecurave që gjykatat kanë tepër. Përcaktimi i nevojave reale dhe për autovecurat që janë tepër të merren masa për evadimin e tyre. Kërkohet që sektori të fuqizohet me investime të reja, pasi shumë makina janë të konsumuara dhe kërkohet një shpërndarje më racionale.
9. Një reformim i pagesave të avokatëve pasi kemi dy standarde, rrjedhë e dy udhëzimeve për pagesat e avokatëve kryesisht, të cilat bien ndesh. Duhet bërë me dije Ministria e Drejtësisë për këtë problem.
10. Unifikimi i sistemit të raportimit financiar në gjykata dhe udhëzimit mbi ndjekjen e të ardhurave për gjyqësorin.
11. Organizimi dhe trajnimi me të gjitha gjykatat, mbi paketat e reja ligjore të administrimit publik dhe detyrimet dhe përgjegjësitë e reja të menaxhimit publik, që fillojnë më 1 janar 2012.
12. Miratimi nga kryetari i Bordit i gjurmëve specifike të auditimit për gjyqësorin.

13. Hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme për gjykatat duke implementuar ligjet e menaxhimit dhe kontrollit financiar publik si dhe ligjin mbi ruajtjen e objekteve publike me polici private.

IV.4.3.1.C.1.Auditimet e plota kundrejt auditimeve tematike

Shmangiet nga plani vjetor janë reflektuar dhe në shmangien e realizimit sipas llojeve të auditimeve të kryera në raport me llojet e parashikuara. Sipas parashikimeve në Planin Vjetor 2011 llojet e auditimeve të parashikuara klasifikohen si vijon:

Auditime të Plota financiare- 14

Auditime Tematike- 1

Janë realizuar 14 auditime të plota me bazë sistemi. Kanë përfunduar dhe me dërgim raportesh final.

Janë në proces Gjykata e Rrethit Vlorë dhe Gjykata e Apelit Tiranë.

IV.4.3.1.C.2.Fushat me risk më të lartë dhe trajtimi i tyre

Në Planet Strategjike dhe Vjetore të auditimit të brendshëm janë identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore për veprimtarinë e gjykatave. Deri në vitin 2011 e kemi vlerësuar riskun në mënyre empirike dhe mbi bazë përvoja e gjetje auditimi. Për vitin 2012 do bëjmë vlerësim real risku me tregues për çdo gjykatë.

Në Ligjin për Auditimin e Brendshëm dhe Manualin e Procedurave janë përcaktuar dhe metodologjitë që përdoren për vlerësimin e riskut dhe pikërisht bazuar në këtë sistem të vlerësimit të riskut, njësia e auditimit do të programojë dhe auditimin e fushave dhe subjekteve që paraqiten me një nivel të lartë risku. Nga analiza e raporteve vjetore individuale si dhe nga intervistat e realizuara, rezulton se përcaktimi i nivelit të riskut është bërë duke marrë në konsideratë faktorët e riskut të cilët në mënyrë të përmbledhur do të përgjithësoheshin në kategoritë e mëposhtme:

- Sasia dhe përdorimi i burimeve në dispozicion të gjykatës të audituar;
- Zbatimi i ligjshmërisë, politikave, procedurave, rregulloreve e planeve;
- Arritja e objektivave dhe rezultateve të pritshme;
- Ruajtja dhe miradministrimi i aseteve, pronë publike
- Funkcionet kryesore, organizimi dhe kompleksiteti i gjykatës që auditohet;
- Kërkesat e raportimit financiar;
- Mjedisi i kontrollit në gjykata;

- Shkalla e ndryshimeve organizative dhe në drejtim;
- Mbulimi i pamjaftueshëm me auditime në të kaluarën.

Duke u bazuar në përcaktimin e fushave me risk më të lartë, sa më sipër, struktura audituese ka vendosur dhe prioritetet e saj. Kështu në subjektet apo fushat me risk më të lartë janë angazhuar të gjitha burimet e auditimit me kohë të gjatë auditimi, që do të thotë që në këta auditime është përfshirë stafi me nivel të lartë profesional dhe është siguruar kohë e mjaftueshme për vlerësimin e subjekteve. Në auditime me risk ka marrë pjesë vetë drejtuesi i strukturës.

Megjithatë, si rezultat i rivlerësimit të riskut, gjatë vitit dhe kur menaxhimi e ka gjykuar të arsyeshme, për fusha të cilat risku në situata të veçanta paraqitet më i lartë se vlerësimi në Planin Vjetor, do të kryhen dhe misione auditimi me urdhër të veçantë.

Atje ku risku është vlerësuar i një niveli të lartë, vëmendje e madhe i është kushtuar procesit të ndjekjes së rekomandimeve duke synuar jo vetëm përcaktimin e efekteve të shkaktuara apo përgjegjësi, por mbi të gjitha përmirësimin dhe parandalimin e përsëritjes së fenomeneve të tilla në të ardhmen.

Bazuar në faktorët e përmendur më sipër vlerësojmë me risk më të lartë fushat në vijim:

- 1• Sistemet e menaxhimit financiar. Pjesa më e madhe e të audituarve gjykojnë se pikërisht menaxhimi financiar është fusha ku risku është më i pranishëm. Po t'i referohemi analizës në seksionin "Gjetjet më të rëndësishme" të këtij raporti janë pikërisht fushat e: prokurimeve publike, pagave, transaksioneve financiare, mbledhjes së të ardhurave, taksat në të cilat janë zbuluar dhe shkeljet më të rëndësishme; Aplikimi i standardeve të reja është me rrisht.
- 2• Gjykatat që qarkullojnë shuma të konsiderueshme të fondeve publike të cilat sigurohen nga një numër i madh burimesh financimi, ku përfshihen dhe të ardhurat.
- 3• Investimet në Godina të Reja, ku përfshihet jo vetëm zbatueshmëria e kuadrit ligjor, por dhe shkalla e cilësia e implementimit të kontratave. Këto fusha shfaqen jo vetëm me risk të lartë financiar por dhe operacional që ka të bëjë me cilësinë e punimeve, pagesat jo në konformitet me gjendjen aktuale të punimeve, mbikqyrjen dhe marrjen në dorëzim të objekteve.
- 4• Gjykatat apo fushat me dobësi të theksuara në sistemin e kontrollit të brendshëm, e cila shfaqet me mangësitë në kuadrin rregullator e procedural brenda vetë subjektit publik. Kjo ka të bëjë me gjykata të cilat kanë pësuar ndryshime strukturore dhe nuk e kanë plotësuar

akoma bazën rregullatore dhe funksionale të tyre si dhe mungesa e burimeve njerëzore dhe e rregulloreve të brendshme.

5• Menaxhimi i burimeve njerëzore, pasi qarkullimi i shpeshtë i stafit dhe niveli i ulët profesional i punonjësve ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave dhe cilësinë e punës

6• Gjykata me nivel të ulët të njohurive dhe përdorimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit. Njohuritë e pamjaftueshme për këto sisteme bëjnë që subjektet të ekspozohen në një shkallë të lartë të riskut pasi nuk mund të përshtaten dhe të përdorin sisteme të tilla që shpesh janë dhe të detyrueshme (psh. sistemi ORAKULL, sistemi i përgatitjes së PBA-së, apo prokurimet publike). Ka gjykata që përpunojnë informacionet e tyre në mënyrë manuale, ku risku i gabimeve në llogaritje apo të dhëna shfaqet i lartë

IV.4.3.1.C.3. Gjetjet kryesore dhe vlerësimet e sistemeve

Në ushtrimin e funksionit të tyre, strukturat e auditimit, kanë nxjerrë në pah hallkat më të dobëta dhe jo funksionale të sistemit, të cilat kanë sjellë dhe pasojat e tyre negative në përdorimin me dobi, kursim dhe frytshmëri të fondeve publike. Gjetjet e konstatuara nga strukturat e auditimit të brendshëm konsistojnë në 3.680 mijë lekë paraqiten si vijon:

- a. Shkelje të disiplinës financiare - 2.900 mijë lekë
- b. Mospagim takse shërbimi gjyqësor - 780 mijë lekë
- c. Mungesa dhe dëmtime të tjera - s'ka

Në gjykata janë lënë 96 rekomandime të karakterit teknik dhe organizativ, dhe reagimet dhe pritshmëria kanë qenë pozitive.

Është arkëtuar Gjykata Lezhë – 1.488 mijë lekë dhe vazhdon në të tjerat arkëtimi.

Për kategorinë e gjetjeve të sipërpërmendura, vlerësohet se peshën kryesore e zënë gjetjet në ato fusha të cilat në Planin Vjetor kanë qenë përcaktuar si fusha me risk më të lartë dhe që lidhen kryesisht me zbatimin jo të drejtë të kuadrit ligjor në sistemin e:

- Pagave dhe pagesave të tjera për punonjësit (veçanërisht llogaritjet e orëve jashtë orarit, shpërblime etj);
- Tatim-taksave (mbledhjen e të ardhurave nga tarifat e shërbimeve gjyqësore në buxhet)
- Transaksionet monetare në veprimet me arkën dhe bankën;

Gjetjet e përsëritura thuajse për të njëjtat fusha, tregojnë për një punë jo eficientë në zbatimin e rekomandimeve të auditimit si dhe në menaxhimin e riskut nga drejtuesit e gjykatave dhe zyrat e financave në gjykata

IV.4.4. Rekomandimet e auditimit

IV.4.4.1. Përcaktimi i përgjegjësive, propozimet për masa disiplinore e administrative

Krahas problematikës së ngritur në seksionin e mësipërm vihet re se për gjetjet e konstatuara nga strukturat audituese **është përcaktuar plotësisht përgjegjësia**. Ky fakt konsiderohet si një tregues pozitiv i performancës së auditimit të brendshëm dhe tregon se rezultatet e punës janë shtrirë përtej konstatimit të gjetjeve.

Në bazë të manualit të ri janë kryetarët e gjykatave që japin masa mbi bazën e gjetjeve të auditimit. Është përgjegjësi e kryetarëve të reagojnë mbi bazën e raportit final të auditit.

Përcaktimi i përgjegjësive ka sjellë efekte pozitiv dhe në dhënien e propozimeve për uljen e pasojave të mangësive dhe shkeljeve të konstatuara. Megjithatë, si rezultat i përmirësimit të cilësisë së punës dhe parandalimin e mospërsëritjes së shkeljeve dhe kthimin në fenomene negative në të ardhmen për subjektet e audituara, struktura e auditimit ka rekomanduar masa disiplinore e administrative të cilat konsistojnë në :

- është dhënë largim nga puna në Gjykatën e Lartë
- arketim detyrimi në arkën e shtetit në shumat e gjetura nga auditit dhe të pranuar si dëm ekonomik.

Masa teknike dhe organizative në përmirësimin e punës në gjykatë:

- Në aspektin organizativ dhe prokurime publike
- Në administrimin sa më të mirë ekonomik të gjykatës.

IV.4.4.2. Propozimet për strukturën e rekomandimeve

Në ushtrimin e funksionit të tyre, Njësia audituese përqëndron një pjesë të madhe të përpjekjeve të saj në dhënien e rekomandimeve për Kryetarët, të cilat synojnë përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe veprimtarisë së gjykatave për arritjen e objektivave. Për këtë qëllim, vlerësimi i sistemeve të MFK dhe veprimtarisë së gjykatave shoqërohet me dhënien e rekomandimeve, të cilat duhet të jenë të sakta, realiste dhe të zbatueshme. Në përgjithësi rekomandimet e dhëna gjatë vitit 2011 do të klasifikoheshin në grupet e mëposhtme:

1. Rekomandime që lidhen me *përmirësimin e proceseve të vendimmarrjes, të politikave dhe procedurave, hartimit të strategjive dhe përcaktimit të objektivave në gjykatat e audituara përmirësimi i strukturave vendimmarrëse dhe veprimtarisë së tyre, riorganizimi në status i ndarjes së detyrave (arkë, magazinë, financë, punonjës me ndjekjen e taksave dhe shpeshherë rishikimi i funksioneve të tyre dhe menaxhimit të lartë); hartimi i rregulloreve*
2. Rekomandime për *përmirësimin e proceseve të implementimit të politikave, kuadrit ligjor e procedural të brendshëm e të jashtëm që drejton veprimtarinë e gjykatave (vendosja e procedurave, rregullave të qarta për parandalimin e fenomeneve negative, verifikimeve, autorizimeve, ndarja e detyrave sipas funksioneve dhe roleve të çdo zyrtari*
3. Rekomandime për *përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar me qëllim që të sigurohet përdorimi me efektivitet, ekonomi dhe efikasitet i fondeve publike (rritja e cilësisë së planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit, vendosja e rregullave të kujdesshme për parandalimin e mashtrimit dhe vjedhjes, ruajtjen e aseteve etj.);*
4. Rekomandime për *zhvillimin profesional të punonjësve në subjektet publike dhe sidomos stafit që punon në strukturat e menaxhimit financiar.*
5. Rekomandime për *ngritjen dhe zhvillimin profesional të kapaciteteve kontrolluese në gjykatë (gjykatat e medha)*

IV.4.4.3. Përgjigjia dhe reagimet e menaxhimit

Sikurse përcaktohet dhe në misionin e auditimit të brendshëm, objektivi strategjik i tij është *dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sistemit dhe shtimin e vlerës së subjektit nga kryetarët e gjykatave.*

Arritja e këtij objektivi përcaktohet në një masë të madhe nga cilësia dhe zbatueshmëria e rekomandimeve, por tregon gjithashtu përgjegjësinë e auditimit për të gjetur rrugët më efektive për ndërgjegjësimin e menaxhimit të subjekteve publike mbi vlerën dhe përfitimet nga zbatimi i rekomandimeve. Është e njohur që përgjegjësia e zbatimit të rekomandimeve rëndon mbi vetë drejtuesit e subjekteve të audituara, por nga ana tjetër përgjegjësia e auditimit të brendshëm nuk kufizohet vetëm në dhënien por dhe në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve pasi dhe rezultatet e punës audituese varen në një masë të madhe nga ky faktor. Nëse auditimi i brendshëm do të luajë një rol pasiv, i cili do të konsistonte thjesht në dhënien e rekomandimeve, që jo rrallë rezultojnë të paqarta dhe të paaplikueshme, atëherë nuk do të bëhej fjalë për përmbushje të misionit dhe objektivave të tij strategjikë, pra për vlerë të shtuar të subjektit të audituar apo përmirësim të veprimtarisë së gjykatës.

Rezulton se për vitin 2011 nga 14 gjykata të audituara është konfirmuar zbatimi i rekomandive për 13 gjykata dhe 1 është në proces raportimi.

Ky tregues përbën dhe vlerësimi që i bëhet punës audituese.

IV.4.4.4. Mbikëqyrja e veprimtarisë së strukturave audituese

Sigurimi i cilësisë i përcaktuar në standartin 1310 të IIA-së përcakton detyrimin që:

”Drejtuksi i njësisë së auditimit duhet të hartojë dhe të mbajë një program që të sigurojë cilësinë e auditimeve të kryera dhe të vlerësojë veprimet e njësisë së auditimit të brendshëm.”

Qëllimi i këtij programi është të krijojë një siguri të arsyeshme në përputhje me standardet dhe praktikatat profesionale të auditimit të brendshëm, të kartës së auditimit e standardeve të tjera të apikueshme. Pjesë e rëndësishme e sigurimit të cilësisë është mbikëqyrja dhe rishikimi i jashtëm i veprimtarisë së strukturave audituese.

Përputhja me standardet e aplikueshme shkon përtej pajtueshmërisë me politikat dhe procedurat e miratuara pasi përfshin: vlerësimin e performancës së vetë njësisë së auditimit dhe nivelin e efektivitetit të saj.

Në ligjin e auditit përcaktohet se në përgjithësi mbikëqyrja dhe vlerësimi i njësive të auditimit të brendshëm të ngritura pranë subjekteve publike kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit. Ndërkohë që vetë njësitë e auditimit të ministrive të linjës dhe institucioneve qëndrore bëjnë rishikimin e brendshëm të cilësisë dhe mund të bëjnë vlerësimin për njësitë. I jashtëm behet nga Auditimi i Ministrise së Finanaceve me ligj të posacem.

Për vetë burimet në dispozicion ne nuk kemi bërë auditim të cilësisë.

IV.4.5. Konkluzione dhe rekomandime

Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur që jep siguri objektive, i konceptuar për të shtuar vlerën e subjektit publik të gjykatave. Ai mbështet menaxhimin duke dhënë siguri që kontrollet janë ngritur në pajtueshmëri me rregullat dhe standardet dhe sipas parimeve të shëndosha të menaxhimit financiar, dhe njëkohësisht ofron rekomandime për përmirësimin dhe funksionimin efikas të këtyre kontrolleve.

Si një nga “tre shtyllat” e sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, funksioni i auditimit zhvillohet dhe përmirësohet në vazhdimësi në mënyrë që të fitojë rolin e tij të ri modern si vlerësues dhe këshillues për sistemet dhe të sigurojë arritjen e objektivit të tij strategjik, gjithnjë në pajtueshmëri me standardet dhe praktikatat më të mira.

Nën këtë këndvështrim qëndrimi ynë është dhe do të jetë gjithnjë kritik kundrejt problemeve dhe risqeve që ndikojnë në përmbushjen e misionit të auditimit të brendshëm në gjykata si subjekte publike dhe përgjegjëse të përdorimit të financave publike.

V. Bashkëpunimi me Institucionet e tjera

Gjatë vitit 2011, përfaqësues të Zyrës kanë marrë pjesë në grupe të ndryshme pune të ngritura nga institucionet me të cilat bashkëpunon Zyra si: Grupet e Punës të ngritura nga Ministria e Drejtësisë për: Monitorimin e zbatimit të Strategjisë Sektoriale të Drejtësisë dhe Planit të Veprimit; Hartimin e projektit Për Monitorimin me kamera në sallat e gjyqimit; Përlllogaritjen e shpenzimeve gjyqësore të një seance gjyqësore penale/civile.

Janë dhënë kontribute për plotësimin e Rekomandit nr.7 të BE-së, për pjesën që i takon Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor si dhe është hartuar Plani i Veprimit 2012-2014 për këtë Rekomandim.

Gjithashtu Zyra çdo vit ka përfaqësuesin e saj në Komitetin Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimin të Organizuar, pranë Ministrisë së Financave, i cili merr pjesë në mbledhjet që kryen komiteti çdo 3/muaj.

VI. Sfidat dhe objektivat për vitin 2012

Pas analizës së aktivitetit vjetor, arritjeve dhe problematikës së evidentuar, na del si detyrë që për vitin 2012 të merren masa për përmirësimin e mëtejshëm të aktivitetit të Zyrës.

Gjatë vitit 2012, në kuadër të Planit të Veprimit të Strategjisë Sektoriale të Drejtësisë, do të hartohet dhe miratohet ligji i ri i ZABGJ-së. Për këtë është i nevojshëm një angazhim i plotë për dhënien e kontributeve për hartimin e tij. Në funksion të ligjit të ri, do të përmirësohet edhe rregullorja e brendshme e Zyrës, e cila do të përfshijë midis të tjerave edhe detyrimet që rrjedhin nga Ligji Për MFK-në.

Një nevojë tjetër e evidentuar gjatë vitit 2011, është edhe përmirësimi i strukturës organike të Zyrës, realizimi i përputhshmërisë së saj me aktet ligjore në fuqi si dhe vendosjen e nivelit të duhur të menaxhimit, në funksion të përmbushjes së objektivave dhe aktivitetit të saj.

Gjithashtu nevojitet një punë e vazhdueshme për arritjen e objektivave të përcaktuara, në Deklaratën e Politikës së Programit, në aktivitetin kryesor të buxhetit të vitit 2012.